



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.517/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Suzana Sejdijaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga subjekti politik Alanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, dega në Vushtrri, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale 2017 të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHET** si e pa rregullt ankesa e Suzana Sejdijaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Vushtrri, me seli në Prishtinë, dega në Vushtrri, nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me shenjën ZL.Anr.517/2017, paraqitur me datën e datës 25.10.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

## A r s y e t i m

Me datën 25.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Suzana Sejdijaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga subjekti politik AKR, me të cilën pretendon se janë keqpërdorur votat në Qendrat e Votimit në Komunën e Vushtrrisë, si në vendvotimet: Samadrexha 2712B, Pantin 2711B, Dumnicë 2707B, Nevolan 2709B, Bukosh 2730B, Sh.M.T “Lutfi Musiqi” 2701B, Sh.F “Ali Kelmendi” 2702B, Lumëmadh 2728B, Musafa Venhar 2704B, Stanofc 2729B, Sh. “Naim Frashëri” 2702x, Studime e Epërme 2718, Maxhuna 2714, Smrekonicë 2718B.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullsisë së ankeses gjeti se:

### **Ankesa është e pa rregullt**

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e parashtruar nga ana e Suzana Sejdijaj është e parregullt, sepse nuk është e nënshkruar nga parashtruesja e ankesës dhe si e tillë ankesa nuk i plotëson kërkesat e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 5.6 ku përcaktohet se: *“Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari”*.

Prandaj, PZAP-i nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbeshtejte të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL Anr.517/2017 më datën 25.10.2017.

**Kryesuese e Panelit**

**Gyltene Syljmani**



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*